

PLAN VEPRIMI I OPERATORIT TË BLERJEVE TË PËRQENDRUARA PËR PROKURIMIN E QËNDRUESHËM DHE EKONOMINË RRETHORE



Shtator 2025

Permbajtja

Fjalor i termave:	3
1. Hyrje.....	4
2. Qëllimi dhe Objektivat.....	4
3. Hapat Aktuale të ndërmarra nga OBP	5
3.1 Analiza ligjore dhe teknike	5
3.2 Krijimi i grupit teknik të punës	5
3.3 Marrëveshje me AKPA	5
4. Kufijtë monetare për aplikimin e detyrueshëm të kriterëve të qëndrueshme në kontrata të sektorit klasik	6
5. Kriteret e Qëndrueshme sipas Kategorive të Prokurimit	6
Procedura Prokurimi për Mallra	6
Procedura Prokurimi Shërbime	10
Procedura Prokurimi Punë.....	12
6. Përfshirja në procedurat dhe dokumentet	14
7. Roli i Specialistëve.....	14
9. Hapat e mëtejshëm që do të ndërmerren	16
10. Baza Ligjore dhe Dokumentet Referencë	17
ANEKS	17

Fjalor i termave:

OBP-Operatori i Blerjeve të Përqendruara

BE-Bashkimi Evropian

AKPA-Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

EU Ecolabel, Blue Angel, Energy Star-Certifikata Mjedisore Evropiane

ASTM D6400, EN 13432-Standarde Ndërkombëtare në Fushën e Mjedisit

IT-Teknologjia e Informacionit

ILO-Organizata Ndërkombëtare e Punë

SA8000, BSCI, Sedex, Fair Trade, ISO 26000-Certifikata Ndërkombëtare në Fushën Sociale

BREEAM, LEED-Certifikata në Fushën e Ndërtimit

PPE-Pajisjet e Mbrojtjes Personale

MEAT-Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Kosto

KPI-Indikatorët Kyc të Performancës.

KVO-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

KSHA-Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

DST-Dokumentet Standard të Tenderit

VOC-Tretës Organikë të Paqëndrueshëm

1. Hyrje

Ky dokument përbën një raport të zgjeruar mbi hapat e ndërmarra dhe ato të planifikuara nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP) në drejtim të zbatimit të prokurimit të qëndrueshëm në Shqipëri, kryesisht për aplikimin e kriterëve mjedisore dhe sociale në procedurat e prokurimit që realizohen nga OBP sipas draft raportit nr. 2887 prot. datë 17.09.2025.

Qëllimi i këtij dokumenti është që të shërbejë si bazë teknike dhe strategjike për transformimin e praktikave të OBP në përputhje me objektivat kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm dhe standardet e Bashkimit Evropian. Raporti përshkruan në mënyrë të detajuar iniciativat dhe veprimet e ndërmarra nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP) për të integruar parimet e prokurimit të qëndrueshëm në aktivitetin e tij të prokurimit publik.

Prokurimi i qëndrueshëm është një qasje që integron në mënyrë të qëndrueshme kriteret mjedisore, sociale dhe ekonomike në çdo fazë të procesit të prokurimit. Ai synon që blerjet publike të kenë një ndikim pozitiv afatgjatë, duke mbrojtur mjedisin, promovuar drejtësinë sociale dhe duke nxitur zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

2. Qëllimi dhe Objektivat

Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë mënyrën e zbatimit të parimeve të prokurimit të qëndrueshëm në procedurat e realizuara nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara. Raporti synon të vlerësojë përputhshmërinë e praktikave të prokurimit me objektivat mjedisore, sociale dhe ekonomike të qëndrueshmërisë, përmes analizës së kriterëve që do të aplikohen, sipas llojit të procedurave të prokurimit, përfshirë edhe mënyrën e vlerësimit të tyre.

OBP do të realizojë zbatimin e praktikave të prokurimit të qëndrueshëm, përmes:

- Uljes së ndikimit mjedisor të investimeve, mallrave dhe shërbimeve të prokuruar.
- Përmirësimit të kushteve sociale përgjatë zinxhirit të investimit, furnizimit dhe/ose shërbimit.
- Inkurajimit të operatorëve ekonomikë drejt përmirësimit të performancës së tyre sociale dhe mjedisore.
- Rritjes së transparencës, përgjegjshmërisë dhe inovacionit në kontratat publike duke mbështetur objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Nxitjes së përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullativ të përditësuar dhe harmonizuar me direktivat evropiane.
- Duke mbështetur objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm, OBP synon të bëhet një institucion inovator për sektorin publik në Shqipëri.
- Implementimi i kriterëve të qëndrueshme do të realizohet duke respektuar parime themelore, rferuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Parimi i proporcionalitetit – kriteret duhet të jenë të përshtatura me natyrën dhe vlerën e kontratës.

Parimi i transparencës – kriteret dhe mënyra e vlerësimit duhet të jenë të qarta dhe të shpallen paraprakisht.

Parimi i konkurrencës së ndershme – nuk duhet të penalizohen operatorët për mungesë të aksesit në certifikata të shtrenjta.

Parimi i ndikimit real – kriteret duhet të sjellin përmirësime konkrete mjedisore dhe sociale.

3. Hapat Aktuale të ndërmarra nga OBP

3.1 Analiza ligjore dhe teknike

Është kryer një analizë e plotë e kuadrit ligjor kombëtar dhe praktikave ndërkombëtare në fushën e prokurimit të qëndrueshëm. Janë identifikuar hapësirat ligjore për integrimin e kriterëve të qëndrueshëm në ciklin e prokurimit të OBP. Janë pilotuar kriterë sociale dhe mjedisore në disa procedura, të korporuara si kriterë pikëzimi. Shembujt e kriterëve mjedisore dhe sociale të pasqyruara sipas Aneksit të këtij raporti janë hartuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për këto fusha, duke mbajtur në konsideratë edhe kufizimet ligjore dhe teknike. Shqipëria në procesin e integritetit drejt Bashkimit Evropian ka detyrimin për adoptim të direktivave për prokurimin publik që përfshijnë kriterë të qëndrueshëm. Kjo përfshin direktivat që rregullojnë prokurimin publik të mallrave, shërbimeve dhe punëve, dhe kërkesat e BE-së për qëndrueshmëri mjedisore, sociale, transparencë dhe llogaridhënie. Hartimi i katalogëve teknikë nga OBP dhe publikimi i tyre edhe nga Agjencia e Prokurimit Publik është një hap praktik drejt harmonizimit të legjislacionit shqiptar me direktivat evropiane.

3.2 Krijimi i grupit teknik të punës

Është ngritur një grup teknik i dedikuar për hartimin e raportit dhe udhëzuesit për zbatimin e kriterëve të qëndrueshëm, në dokumentet e tenderit për procedurat e prokurimit që zhvillohen nga Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

3.3 Marrëveshje me AKPA

Është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me (AKPA) për harmonizim institucional dhe mbështetje për përhapjen graduale të prokurimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar. Kjo praktikë synon të reduktojë papunësinë si edhe të promovojë një model të ri të prokurimit publik, ku blerjet dhe investimet shtetërore kontribuojnë drejtpërdrejt në mbështetjen e grupeve më të cenueshme të shoqërisë.

Përmes përfshirjes së këtij kriteri pikëzimi në vlerësimin e ofertave, ku operatorët që angazhohen të punësojnë individë të papunë marrin pikë shtesë, është mundur:

- ✓ Nxitja e përfshirjes në tregun e punës për persona të regjistruar në zyrat e punës;
- ✓ Angazhimi i sektorit privat në objektiva sociale përmes instrumenteve të prokurimit;
- ✓ Rritja e impaktit të kontratave publike në zhvillimin social.

Ky model ka treguar se prokurimi publik mund të shërbejë jo vetëm si mekanizëm për blerje efikase, por edhe si instrument zhvillimi social dhe gjithëpërfshirje, në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe politikat kombëtare të punësimit.

Implementimi i suksesshëm i këtij kriteri në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit, të zhvilluara nga OBP, shërben edhe si një nxitje e mëtijshme për aplikimin e prokurimit të qëndrueshëm

4. Kufijtë monetare për aplikimin e detyrueshëm të kriterëve të qëndrueshëm në kontrata të sektorit klasik

Përdorimi i kriterëve sociale dhe mjedisore zbatohet në këto raste:

Për procedura prokurimi për Mallra: $\geq 20,000,000$ lekë

Për procedura prokurimi për Shërbime: $\geq 30,000,000$ lekë

Për procedura prokurimi për Punë publike: $\geq 50,000,000$ lekë

Për kontratat nën këto kufij, kriteret mund të aplikohen në mënyrë vullnetare ose të integrohen në specifikimet teknike pa pikëzim shtesë.

5. Kriteret e Qëndrueshëm sipas Kategorive të Prokurimit

Procedura Prokurimi për Mallra

Shembuj kriteresh mjedisore:

Për procedurat e prokurimi me qëllim blerjen e mallrave në kuadër të implementimit të kriterëve mjedisore të qëndrueshëm, një peshë të rëndësishme mbart parimi i ekonomise rrethore. Ekonomia rrethore në prokurim nënkupton blerjen e mallrave që minimizojnë përdorimin e burimeve natyrore, reduktojnë mbetjet, kanë jetëgjatësi më të lartë, janë të ripërdorshëm, të riparueshëm ose të riciklueshëm dhe që nuk krijojnë ndotje në fazën e përdorimit ose asaj të hedhjes.

» Certifikatë mjedisore (EU Ecolabel, Blue Angel, Energy Star).

Produkte me minimum 30% përmbajtje të ricikluar.

Zbatim kriteri: Dokument zyrtar nga prodhuesi që deklaron përqindjen e materialeve të ricikluara në produktin e ofruar; Certifikatë apo deklaratë teknike që specifikon përqindjen e saktë të përmbajtjes së ricikluar; Testime të pavarura laboratorike që vërtetojnë përmbajtjen e ricikluar në produkt; Raporte që bëjnë verifikimin e materialeve të përdorura; Dokumente që tregojnë se produkti është certifikuar sipas standardeve të caktuara mjedisore që kërkojnë përmbajtje të ricikluar, si p.sh. EU Ecolabel; Dokumente që dëshmojnë blerjen e materialeve me përmbajtje të ricikluar nga furnizues të certifikuar.

» Reduktimi i Burimeve Natyrore të Papërpunuara ne kuader te zbatimit te ekonomise rrethore

Zbatim kriteri: Dokument qe evidenton burimin e sigurimit te lëndës së parë. Dëshmi për ofrimin e mallrave me më pak përdorim të burimeve natyrore dhe më tepër burime të ricikluara.

» Paketim i reduktuar dhe biodegradueshëm

Zbatim kriteri: Certifikata nga laboratore të akredituar që vërteton se materialet e paketimit janë te biodegradueshëm sipas standardeve ndërkombëtare (p.sh. ASTM D6400, EN 13432); Dokument zyrtar që konfirmon se paketimi plotëson kriteret për biodegradueshmëri; Dokument zyrtar që deklaron përdorimin e materialeve biodegradueshme dhe paketim me sasi minimale materialesh; Specifikime teknike që tregojnë përbërjen dhe karakteristikat e paketimit; Dokumentacion që tregon masat e ndërmarra për reduktimin e sasisë së paketimit (p.sh. dizajn më efikas, përdorim materiali më të lehtë); Etiketë mjedisore që certifikon paketimin si i biodegradueshëm dhe me ndikim të ulët mjedisor.

» Konsumi i energjisë nën 0.5 kwh për njësi (p.sh. për printera ose pajisje IT) ose pajisjet elektrike duhet te jene te klasit A+ (ose edhe me larte).

Zbatim kriteri: Certifikata zyrtare nga autoritetet kompetente ose nga prodhuesi që vërteton klasën energjetike të pajisjes (p.sh. A+, A++, etj.); Dokumente teknike që tregojnë konsumin e energjisë për njësi (p.sh. kwh për orë ose për cikël pune); Etiketa që vendoset në pajisje dhe që tregon klasën energjetike sipas standardeve (EU Energy Label ose ekuivalent); Raporte të testimeve të pavarura që konfirmojnë vlerat e konsumit të energjisë.

» Emetime të CO₂ nën pragun e lejuar për automjete ($\leq 95\text{g/km}$)

Zbatim kriteri: Dokument zyrtar i lëshuar nga autoritetet shtetërore ose organizata homologuese që tregon specifikimet teknike të automjetit, përfshirë emetimet e CO₂ (g/km) dhe kjo çertifikate duhet të vërtetojë që automjeti plotëson standardin e emetimeve, pra $\leq 95\text{g CO}_2/\text{km}$. Raport laboratorik ose testim i pavarur (p.sh. nga laboratorë të akredituar) që tregon matjet e emetimeve për automjetin; Dokumentacion i prodhuesit ku përmendet saktë niveli i emetimeve të CO₂ për modelin specifik të automjetit; Etiketë ose certifikatë që vërteton klasifikimin mjedisor të automjetit në bazë të emetimeve

» Emetimi i substancave ndotëse

Zbatim kriteri: Dokument zyrtar nga autoritetet shtetërore ose nga organizatat homologuese që specifikon nivelin e emetimeve të substancave ndotëse sipas standardeve kombëtare ose ndërkombëtare (p.sh. EURO 6 për automjetet). Certifikata duhet të përfshijë matjet e substancave ndotëse kryesore: NO_x, PM (partikula), CO, VOC etj. Raportet e testimit laboratorik dhe matjet teknike ku përfshihen Raporte të testimeve të pavarura nga laboratorë të akredituar që vërtetojnë se pajisja/automjeti ka emetime nën kufijtë e lejuar dhe mund të përfshijnë matje të emetimeve në kushte reale ose sipas standardeve laboratorike. Dokumente teknike të prodhuesit ku përshkruhen

emetimet maksimale të substancave ndotëse. Dokumente nga inspektimet periodike që tregojnë se pajisja/automjeti përputhet me kërkesat për emetimet e substancave ndotëse.

» Jetëgjatësia dhe riparueshmëria e produktit.

Zbatim kriteri: Garancia dhe certifikata nga prodhuesi, një dokument zyrtar që tregon periudhën e garancisë së produktit, duke dëshmuar jetëgjatësinë minimale të pritshme; Certifikata që mund të përfshijë edhe informacion mbi mundësitë e riparimit dhe rezervat e pjesëve; Manuale përdorimi dhe udhëzime teknike që përshkruajnë procesin e riparimit dhe mirëmbajtjes; Vërtetim për disponueshmëria e pjesëve të këmbimit dhe komponentëve të produktit; Raporte të testimeve laboratorike ose praktike që vërtetojnë jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e produktit në përdorim normal; Teste që provojnë mundësinë dhe lehtësinë e riparimit; Dokumente që tregojnë nëse operatori ekonomik ofron shërbime riparimi, mundësi garantimi për riparueshmëri dhe planet e riciklimit të produktit pas përdorimit.

» Përdorimi i teknologjive të gjelbra në prodhim.

Zbatim kriteri: Certifikata që konfirmon përdorimin e teknologjive që reduktojnë ndotjen, konsumimin e energjisë dhe ujit; Raporte nga auditime të brendshme ose të palëve të treta që verifikojnë implementimin e teknologjive të gjelbra në linjat e prodhimit; Dokumente zyrtare të firmosura nga operatori ku përshkruhen teknologjitë dhe proceset e gjelbra që përdoren në prodhim; Politika të brendshme dhe plane veprimi për qëndrueshmërinë; Dokumentacion mbi investimet në pajisje të reja, sisteme të energjisë së rinovueshme, përdorim efikas të burimeve, etj; Bashkëpunime me institucione apo programe që promovojnë teknologjitë e gjelbra.

Shembuj kriteresh sociale:

» Operatori ekonomik të dëshmojë respektimin e standardeve ILO.

Zbatim kriteri: Plane dhe politika punësimi, raporte auditimi; Dokumente që tregojnë se operatori ka politika të shkruara për respektimin e standardeve ILO, përfshirë barazinë, sigurinë dhe shëndetin në punë, oraret e punës, mospërdorimin e punës së fëmijëve dhe punës së detyruar; Raporte vjetore ku përshkruhen masat e marra dhe praktikatat e mira në përputhje me ILO; Dëshmi për trajnime të stafit mbi të drejtat e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë sipas standardeve ILO; Letra rekomandimi ose vlerësime nga klientë që vërtetojnë respektimin e këtyre standardeve.

» Ndalohet furnizimi nga vende me punë të detyruar ose punë të fëmijëve.

Zbatim kriteri: Deklarata duhet të jetë e firmosur nga përfaqësuesi ligjor; Dokument që përshkruan kushtet dhe masat për kontrollin e zinxhirit të furnizimit për shmangien e punës së detyruar dhe punës së fëmijëve; Raporte ose certifikata nga auditime të pavarura që vërtetojnë se zinxhiri i furnizimit është i lirë nga punë e detyruar dhe punë fëmijësh; Përfshirja e këtij kriteri në raportet periodike sociale dhe etike të kompanisë.

» Zbatimi i kodeve etike ose auditime sociale.

Zbatim kriteri: Dokument zyrtar nga një organizatë e pavarur që ka kryer auditim social; Raporte të auditimeve të kryera me rezultatet dhe rekomandimet; Dokumenti zyrtar i kompanisë që përmban kodin etik, i firmosur dhe i publikuar; Deklaratë e operatorit ekonomik që ai të zbatojë kode etike dhe se është i gatshëm të përfshihet në auditime sociale; Raporte ku përshkruhen masat, politikat dhe rezultatet në fushën e etikës dhe auditimeve sociale; Dokumente apo letra rekomandimi që dëshmojnë respektimin e kodeve etike në bashkëpunim.

» Çertifikime sociale.

Zbatim kriteri: Dokumenti origjinal ose kopje të certifikatës të lëshuar nga organizata e certifikimit (p.sh., SA8000, BSCI, Sedex, Fair Trade, ISO 26000 etj.); Raporte që shoqërojnë certifikatën dhe tregojnë përputhshmërinë me standardet sociale të kërkuara; Dokumentacion nga organi certifikues që konfirmon vlefshmërinë dhe statusin e certifikimit.

» Paga dhe kushtet e punës të barabarta.

Zbatim kriteri: Vetedeklarim; Dokumente zyrtare që tregojnë që kompania ka politika për pagat e barabarta për punë me vlerë të barabartë, pa diskriminim gjinor apo tjetër; Raporte të brendshme ose nga auditime të pavarura që konfirmojnë zbatimin e barazisë në pagë dhe kushte pune; Përfshirja e masave dhe rezultateve në raportet e përgjegjësisë sociale, ku tregohen progresi në barazinë gjinore dhe kushte të mira pune; Referenca apo dëshmi nga sindikatat ose punonjësit nëpërmjet një dokumenti që vërteton respektimin e barazisë në marrëdhëniet me punonjësit.

» Përfshirja në projekte me ndikim social.

Zbatim kriteri: Vetedeklarim; Përshkrim zyrtar i projekteve sociale ku kompania ka marrë pjesë, me detaje mbi qëllimet, rezultatet dhe ndikimin; Dokumente që tregojnë bashkëpunimin me organizata sociale, institucione publike, ose donatorë për realizimin e projekteve me ndikim social; Dokumente nga partnerët ose organizatat që certifikojnë pjesëmarrjen aktive në projekte sociale; Materiale që dokumentojnë aktivitetet sociale të kompanisë; Letra rekomandimi ose referenca që vërtetojnë kontributin e kompanisë në projekte sociale. Deklarate angazhimi për bashkëpunime me institucione si shkolla, spitale, shtëpi të moshuarish, etj.

» Përdorimi i produkteve dhe shërbimeve të bizneseve të vogla dhe të mesme lokale, me fokus në zonat e zhvillimit të kufizuar.

Zbatim kriteri: Dokumentacion mbi planifikimin e furnizimeve nga operatori, me lista furnitorësh dhe kontrata paraprake, dokumentacion financiar që tregon blerjet nga bizneset lokale, deklarata nga furnitorët lokalë për bashkëpunimin.

» Angazhimi për mbrojtjen dhe promovimin e traditave dhe kulturës lokale nëpërmjet bashkëpunimeve dhe projekteve sociale.

Zbatim kriteri: Raporte ose përshkrime projektsh dhe bashkëpunimesh; Dokumente bashkëpunimi me organizata kulturore ose komunitete lokale; Materiale promovuese, fotografi, video ose publikime; Vetedeklarim.

Procedura Prokurimi Shërbime

Shembuj kriteresh mjedisore:

» Zbatimi i metodave ekologjike në ofrimin e shërbimit të kërkuar.

Zbatim kriteri: Plan menaxhimi mjedisor: Dokument që përshkruan masat që do të merren për mbrojtjen e mjedisit gjatë ofrimit të shërbimit. Materiale mbështetëse (broshura teknike, lista pajisjesh ose produktesh me ndikim të ulët në mjedis).

» Përdorimi i produkteve dhe materialeve me certifikim ekologjik gjatë ofrimit të shërbimit.

Zbatim kriteri: Listë e produkteve dhe materialeve që do të përdoren në ofrimin e shërbimit. Kopje të certifikatave ekologjike për secilin produkt ose material. Deklaratë e nënshkruar nga operatori ekonomik për angazhimin në përdorimin ekskluziv të produkteve të certifikuara ekologjikisht gjatë zbatimit të kontratës. Broshura teknike ose fletë të të dhënave të produkteve, ku përmendet etiketa ekologjike.

» Zbatimi i parimeve të ekonomisë rrethore në ofrimin e shërbimit.

Përshkrimi: Operatorët ekonomikë që ofrojnë shërbimin në përputhje me parimet e ekonomisë rrethore do të vlerësohen me pikë shtesë. Kjo përfshin:

Rivlerësimin dhe ripërdorimin e materialeve ose pajisjeve, aty ku është e mundur;

Zëvendësimin e produkteve njëpërdorimëshe me produkte të ripërdorshme ose të riciklueshme;

Menaxhim i qëndrueshëm i mbetjeve, me ndarje në burim dhe dërgim për riciklim;

Zbatimi i një qarkullimi të mbyllur të materialeve në ofrimin e shërbimit.

Zbatim kriteri: Plan për menaxhimin e mbetjeve dhe materialeve të përdorura, që tregon praktikën e ripërdorimit, riciklimit dhe zvogëlimit të mbetjeve. Deklaratë mbi masat konkrete të ekonomisë rrethore që do të zbatohen në projekt. Përshkrime ose dokumente të shërbimeve të ngjashme të zbatuara më parë me qasje të ngjashme.

Shembuj kriteresh sociale:

» Operatori ekonomik të dëshmojë respektimin e standardeve ILO.

Zbatim kriteri: Plane dhe politika punësimi, raporte auditimi; Dokumente që tregojnë se operatori ka politika të shkruara për respektimin e standardeve ILO, përfshirë barazinë, sigurinë dhe shëndetin në punë, oraret e punës, mos-përdorimin e punës së fëmijëve dhe punës së detyruar; Raporte vjetore ku përshkruhen masat e marra dhe praktikën e mira në përputhje me ILO; Dëshmi

për trajnime të stafit mbi të drejtat e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë sipas standardeve ILO; Letra rekomandimi ose vlerësime nga klientë që vërtetojnë respektimin e këtyre standardeve.

» Ndalohet furnizimi nga vende me punë të detyruar ose punë të fëmijëve.

Zbatim kriteri: Deklarata duhet të jetë e firmosur nga përfaqësuesi ligjor; Dokument që përshkruan kushtet dhe masat për kontrollin e zinxhirit të furnizimit për shmangien e punës së detyruar dhe punës së fëmijëve; Raporte ose certifikata nga auditime të pavarura që vërtetojnë se zinxhiri i furnizimit është i lirë nga punë e detyruar dhe punë fëmijësh; Përfshirja e këtij kriteri në raportet periodike sociale dhe etike të kompanisë.

» Zbatimi i kodeve etike ose auditime sociale.

Zbatim kriteri: Dokument zyrtar nga një organizatë e pavarur që ka kryer auditim social; Raporte të auditimeve të kryera me rezultatet dhe rekomandimet; Dokumenti zyrtar i kompanisë që përmban kodin etik, i firmosur dhe i publikuar; Deklaratë e operatorit ekonomik që ai zbaton kode etike dhe se është i gatshëm të përfshihet në auditime sociale; Raporte ku përshkruhen masat, politikat dhe rezultatet në fushën e etikës dhe auditimeve sociale; Dokumente apo letra rekomandimi që dëshmojnë respektimin e kodeve etike në bashkëpunim.

» Çertifikime sociale.

Zbatim kriteri: Dokumenti original ose kopje të certifikatës të lëshuar nga organizata e certifikimit (p.sh., SA8000, BSCI, Sedex, Fair Trade, ISO 26000 etj.); Raporte që shoqërojnë certifikatën dhe tregojnë përputhshmërinë me standardet sociale të kërkuara; Dokumentacion nga organi certifikues që konfirmon vlefshmërinë dhe statusin e certifikimit.

» Paga dhe kushtet e punës të barabarta.

Zbatim kriteri: Vetedeklarim; Dokumente zyrtare që tregojnë që kompania ka politika për pagat e barabarta për punë me vlerë të barabartë, pa diskriminim gjinor apo tjetër; Raporte të brendshme ose nga auditime të pavarura që konfirmojnë zbatimin e barazisë në pagë dhe kushte pune; Përfshirja e masave dhe rezultateve në raportet e përgjegjësisë sociale, ku tregohen progresi në barazinë gjinore dhe kushte të mira pune; Referenca apo dëshmi nga sindikatat ose punonjësit nëpërmjet një dokumenti që vërteton respektimin e barazisë në marrëdhëniet me punonjësit.

» Përfshirja në projekte me ndikim social.

Zbatim kriteri: Vetedeklarim; Përkthim zyrtar i projekteve sociale ku kompania ka marrë pjesë, me detaje mbi qëllimet, rezultatet dhe ndikimin; Dokumente që tregojnë bashkëpunimin me organizata sociale, institucione publike, ose donatorë për realizimin e projekteve me ndikim social; Dokumente nga partnerët ose organizatat që certifikojnë pjesëmarrjen aktive në projekte sociale; Materiale që dokumentojnë aktivitetet sociale të kompanisë; Letra rekomandimi ose referenca që vërtetojnë kontributin e kompanisë në projekte sociale. Deklarate angazhimi për bashkëpunime me institucione si shkolla, spitale, shtëpi të moshuarish, etj.

» Përdorimi i produkteve dhe shërbimeve të bizneseve të vogla dhe të mesme lokale, me fokus në zonat e zhvillimit të kufizuar.

Zbatim kriteri: Dokumentacion mbi planifikimin e furnizimeve nga operatori, me lista furnitorësh dhe kontrata paraprake, dokumentacion financiar që tregon blerjet nga bizneset lokale, deklarata nga furnitorët lokalë për bashkëpunimin.

» Angazhimi për mbrojtjen dhe promovimin e traditave dhe kulturës lokale nëpërmjet bashkëpunimeve dhe projekteve sociale.

Zbatim kriteri: Raporte ose përshkrime projektsh dhe bashkëpunimesh; Dokumente bashkëpunimi me organizata kulturore ose komunitete lokale; Materiale promovuese, fotografi, video ose publikime; Vetedeklarim.

Procedura Prokurimi Punë

Shembuj kriteresh mjedisore:

» Përdorimi i ndriçimit LED dhe sistemit solar në objekt (Në procedura për studim-projektim).

» Efijensa dhe performanca e Energjisë.

» Përdorimi i pajisjeve të sistemeve ngrohje-ftohje me koeficientë të efijencës dhe performancës së energjisë (COP dhe EER) më të lartë se specifikimet minimale teknike të kërkuara.

Zbatim kriteri: Skeda teknike të pajisjeve dhe të materialeve që kërkohen për pikëzim.

» Përdorimi i materialeve të izolimit termik të ndërtesave me koeficient të transmetueshmërisë termike më të vogël se sa koeficientët e përcaktuar në specifikimet teknike, nëse ka.

Zbatim kriteri: Skeda teknike të pajisjeve dhe të materialeve që kërkohen për pikëzim.

» Zbatimi me sukses i planeve të menaxhimit mjedisor për fazën e ndërtimit (menaxhimi i mbetjeve, reduktimi i ndotjes akustike, reduktimi i pluhurit që krijohet gjatë fazës së ndërtimit).

Zbatim kriteri: Metodologji për planin e menaxhimit mjedisor.

» Riciklim i 60% të mbetjeve të ndërtimit.

Shembuj kriteresh sociale:

» Operatori ekonomik të dëshmojë respektimin e standardeve ILO.

Zbatim kriteri: Plane dhe politika punësimi, raporte auditimi; Dokumente që tregojnë se operatori ka politika të shkruara për respektimin e standardeve ILO, përfshirë barazinë, sigurinë dhe shëndetin në punë, oraret e punës, mos-përdorimin e punës së fëmijëve dhe punës së detyruar; Raporte vjetore ku përshkruhen masat e marra dhe praktikatat e mirë në përputhje me ILO; Dëshmi për trajnime të stafit mbi të drejtat e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë sipas standardeve ILO; Letra rekomandimi ose vlerësime nga klientë që vërtetojnë respektimin e këtyre standardeve.

» Ndalohet furnizimi nga vende me punë të detyruar ose punë të fëmijëve.

Zbatim kriteri: Deklarata duhet të jetë e firmosur nga përfaqësuesi ligjor; Dokument që përshkruan kushtet dhe masat për kontrollin e zinxhirit të furnizimit për shmangien e punës së detyruar dhe punës së fëmijëve; Raporte ose certifikata nga auditime të pavarura që vërtetojnë se zinxhiri i furnizimit është i lirë nga punë e detyruar dhe punë fëmijësh; Përfshirja e këtij kriteri në raportet periodike sociale dhe etike të kompanisë.

» Zbatimi i kodeve etike ose auditime sociale.

Zbatim kriteri: Dokument zyrtar nga një organizatë e pavarur që ka kryer auditim social; Raporte të auditimeve të kryera me rezultatet dhe rekomandimet; Dokumenti zyrtar i kompanisë që përmban kodin etik, i firmosur dhe i publikuar; Deklaratë e operatorit ekonomik që ai zbatonë kode etike dhe se është i gatshëm të përfshihet në auditime sociale; Raporte ku përshkruhen masat, politikat dhe rezultatet në fushën e etikës dhe auditimeve sociale; Dokumente apo letra rekomandimi që dëshmojnë respektimin e kodeve etike në bashkëpunim.

» Çertifikime sociale.

Zbatim kriteri: Dokumenti origjinal ose kopje të certifikatës të lëshuar nga organizata e çertifikimit (p.sh., SA8000, BSCI, Sedex, Fair Trade, ISO 26000 etj.); Raporte që shoqërojnë certifikatën dhe tregojnë përputhshmërinë me standardet sociale të kërkuara; Dokumentacion nga organi certifikues që konfirmon vlefshmërinë dhe statusin e çertifikimit.

» Paga dhe kushtet e punës të barabarta.

Zbatim kriteri: Vetedeklarim; Dokumente zyrtare që tregojnë që kompania ka politika për pagat e barabarta për punë me vlerë të barabartë, pa diskriminim gjinor apo tjetër; Raporte të brendshme ose nga auditime të pavarura që konfirmojnë zbatimin e barazisë në pagë dhe kushte pune; Përfshirja e masave dhe rezultateve në raportet e përgjegjësisë sociale, ku tregohen progresi në barazinë gjinore dhe kushte të mira pune; Referenca apo dëshmi nga sindikatat ose punonjësit nëpërmjet një dokumenti që vërteton respektimin e barazisë në marrëdhëniet me punonjësit.

» Përfshirja në projekte me ndikim social.

Zbatim kriteri: Vetedeklarim; Përshkrim zyrtar i projekteve sociale ku kompania ka marrë pjesë, me detaje mbi qëllimet, rezultatet dhe ndikimin; Dokumente që tregojnë bashkëpunimin me organizata sociale, institucione publike, ose donatorë për realizimin e projekteve me ndikim social; Dokumente nga partnerët ose organizatat që certifikojnë pjesëmarrjen aktive në projekte sociale; Materiale që dokumentojnë aktivitetet sociale të kompanisë; Letra rekomandimi ose referenca që vërtetojnë kontributin e kompanisë në projekte sociale. Deklarate angazhimi për bashkëpunime me institucione si shkolla, spitale, shtëpi të moshuarish, etj.

» Përdorimi i produkteve dhe shërbimeve të bizneseve të vogla dhe të mesme lokale, me fokus në zonat e zhvillimit të kufizuar.

Zbatim kriteri: Dokumentacion mbi planifikimin e furnizimeve nga operatori, me lista furnitorësh dhe kontrata paraprake, dokumentacion financiar që tregon blerjet nga bizneset lokale, deklarata nga furnitorët lokalë për bashkëpunimin.

» Angazhimi për mbrojtjen dhe promovimin e traditave dhe kulturës lokale nëpërmjet bashkëpunimeve dhe projekteve sociale.

Zbatim kriteri: Raporte ose përshkrime projektsh dhe bashkëpunimesh; Dokumente bashkëpunimi me organizata kulturore ose komunitete lokale; Materiale promovuese, fotografi, video ose publikime; Vetedeklarim.

» Plan të sigurisë në kantier.

Zbatim kriteri: Ky plan duhet të përmbajë; Vlerësimin e rrezeve për çdo aktivitet (lyerje, mirëmbajtje, lëvizje skelash, përdorim makinerish, etj.), Masat parandaluese dhe mbrojtëse për secilin rrezik, Pajisjet e mbrojtjes personale (PPE) të detyrueshme, Përgjegjësit për sigurinë (inxhinier sigurie, përgjegjës teknik), Rregulla për hyrje/dalje në kantier dhe kontrollin e vizitorëve, Procedura për ndihmën e parë dhe rastet e emergjencës. Të gjithë punonjësit duhet të marrin trajnim mbi rreziqet në kantier, para fillimit të punës, nënshkruajnë formularin e njohjes me planin e sigurisë. Trajnime periodike në rast ndryshimi të llojit të punimeve.

6. Përfshirja në procedurat dhe dokumentet

Kriteret mund të integrohen në:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit përmes metodës MEAT, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto, ku kriteret mjedisore dhe sociale janë kritere pikëzimi.

Kushtet kontraktuale përmes klauzolave të detyrueshme për raportim, penaltete për mosrespektim, etj.

7. Roli i Specialistëve

Drejtorja Teknike harton dokumentacionin e tenderit dhe përfshin kriteret përkatëse sociale/mjedisore.

KVO merr trajnim paraprak për zbatimin e metodologjisë dhe përdor verifikimin e përmbushjes së kritereve.

KSHA shqyrton ankesat dhe jep mendim nëse kriteret janë plotësuar në përputhje me ligjin.

8. Mekanizmi i Monitorimit dhe Raportimit në OBP

OBP do të zhvillojë formularë vlerësimi për çdo kontratë me kritere qëndrueshmërie.

OBP do të hartojë dhe miratojë formate standarde të vlerësimit të cilat do të përdoren për çdo kontratë që përfshin kritere mjedisore, sociale apo ekonomike. Formularët do të përfshijnë indikatorë të qartë për matjen e :

- ✓ Përdorimit të produkteve të certifikuara mjedisore,
- ✓ Përmbushjes së kushteve kontraktuale që lidhen me qëndrueshmërinë,
- ✓ Respektimit të standardeve ndërkombëtare të punës dhe etikës në zinxhirin e furnizimit.
- ✓ Këto mjete vlerësimi do të përdoren si gjatë zbatimit të kontratës, ashtu edhe në fazën e përfundimit të saj, për të gjeneruar të dhëna për raportim dhe monitorim.
- ✓ Njësitë teknike raportojnë çdo 6 muaj mbi zbatimin.

Njësitë teknike përgjegjëse për monitorimin e kontratave do të raportojnë çdo 6 muaj mbi :

- ✓ Niveli i përmbushjes së kritereve të qëndrueshmërisë,
- ✓ Çdo devijim nga kushtet e kontratës që lidhen me aspektet mjedisore/sociale,
- ✓ Problematikat e hasura dhe rekomandimet për përmirësim.
- ✓ Raportet do të strukturohen sipas KPI-ve të miratuara dhe do të dorëzohen në njësinë qendrore të monitorimit në OBP.
- ✓ Do realizohen kontrolle dokumentare dhe në terren për kontratat me impakt të lartë.

Për kontratat që konsiderohen me impakt të lartë mjedisor ose ekonomik, do të realizohen kontrolle të thelluara për:

- ✓ Dokumentacionin justifikues që vërteton respektimin e kritereve të gjelbërta (p.sh. faturat, certifikatat, dëshmitë e pajtueshmërisë).
- ✓ Vizita fizike në vendin e realizimit të kontratës për të verifikuar në praktikë përmbushjen e kushteve.
- ✓ Kontrolli do të kryhet nga një ekip i përbashkët i OBP dhe institucioneve përfituese dhe mund të përfshijë gjithashtu auditim të pavarur, sipas rastit.
- ✓ Përgatitje e një raporti vjetor për AKPA dhe publikimi online.

OBP do të përgatisë një raport vjetor analitik mbi ecurinë e prokurimeve të qëndrueshme, i cili do të përfshijë:

- ✓ Të dhëna statistikore mbi numrin dhe vlerën e kontratave të gjelbërta,
- ✓ Analizë të përmbushjes së kritereve,
- ✓ Raste suksesi dhe sfida të hasura,
- ✓ Rekomandime për përmirësim.

Ky raport do të publikohet në faqen zyrtare të OBP si pjesë e angazhimit për transparencë dhe llogaridhënie publike.

Platformë e dedikuar për transparencë mbi kontratat e qëndrueshme.

OBP do të zhvillojë ose integrojë një platformë online publike ku do të shfaqen në kohë reale:

Tenderat e shpallur me kritere të qëndrueshme,

Operatoret ekonomikë fitues,

Vlerësimi i performancës së kontratës në lidhje me aspektet e qëndrueshmërisë,

Raportet e monitorimit (në formë të përmbledhur).

Platforma do të shërbejë si instrument për rritjen e transparencës, nxitjen e konkurrencës së ndershme.

KPI-të kryesore për monitorim:

Përqindja e tenderave me kritere të qëndrueshme nga totali.

Përqindja e kontratave që respektojnë kriteret gjatë ekzekutimit.

Numri i operatorëve të certifikuar ambiental/social.

Vlera totale e kontratave të qëndrueshme në vit.

Metodologjia e Pikëzimit.

Metodologjia e pikëzimit synon të garantojë një vlerësim transparent, të drejtë dhe të matshëm të ofertave duke integruar kriteret ekonomike, teknike dhe të qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale.

Çdo nënkriter merr një peshë të përcaktuar brenda grupit kryesor. Vlerësimi bëhet nga komisioni i vlerësimit, duke përdorur dokumentacionin teknik, certifikatat dhe dëshmitë e tjera të paraqitura nga ofertuesi. Pikët jepen në shkallën 0-100, më pas konvertohen në peshën relative (p.sh., nëse një kriter ka 20% peshë dhe merr 80 pikë, vlera në total është 16 pikë).

9. Hapat e mëtejshëm që do të ndërmerren

1. Miratimi i Udhëzuesit Praktik në OBP. Zyrtarizimi dhe publikimi i udhëzuesit praktik që përfshin kriteret e qëndrueshmërisë për prokurimin.

2. Përfshirja Sistematike e Kritereve në Dokumentacionin Standard të Prokurimit. Integrimi i kritereve mjedisore, sociale dhe ekonomike në dokumentet standarde të tenderëve dhe kontratave.

Trajnimi i Stafit të Brendshëm të OBP. Organizimi i trajnimeve dhe workshopeve për ngritjen e kapaciteteve të stafit në përdorimin e kritereve të qëndrueshmërisë.

Zbatimi i Sistem Monitorimit dhe Raportimit përmes KPI-ve. Vendosja dhe funksionimi i një sistemi për matjen, monitorimin dhe raportimin e indikatorëve kryesorë të performancës.

Zgjerimi i Zbatimit në Llojet e Ndryshme të Kontratave. Shtrirja e aplikimit të kritereve të qëndrueshmërisë nga tenderat e vegjël te ato të mëdha, për të gjithë llojet e kontratave.

Informimi dhe Bashkëpunimi me Institucionet Përfituese. Njoftimi dhe edukimi i institucioneve përfituese për rëndësinë dhe detyrimet që rrjedhin nga kriteret e qëndrueshmërisë.

Aneke (bashkëlidhur në dokumentin zyrtar).

Model i listës kontrolluese për DST me kriteret qëndrueshmërie.

Modele specifikimesh teknike për mallra/shërbime (pastrim, automjete, mobilie).

Klauzola të gatshme për kontrata me kushte sociale dhe mjedisore.

Formulari për vetëdeklarimin e operatorit ekonomik për përputhshmëri.

Tabela e KPI-ve për monitorim dhe përmbledhje vjetore.

10. Baza Ligjore dhe Dokumentet Referencë

Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

ISO 20400:2017 – Sustainable Procurement Guidance.

EU Green Public Procurement (GPP) Criteria.

OECD Recommendation on Public Procurement (2015).

Udhëzuesi për Prokurimin e Qëndrueshëm i Komisionit Evropian.

SDG 12 – Konsumi dhe Prodhimi i Qëndrueshëm.

Direktiva 2014/24/BE për Prokurimin Publik.

Direktiva 2014/25/BE për Prokurimin në Sektorin e Shërbimeve Publike.

ANEKS

Shembuj për Kriteret Mjedisore për disa nga prokurimet kryesore sipas kategorive, realizuar nga OBP për MALLRA.

BLERJE AUTOMJETESH

Kriteret mjedisore:

» Automjetet të kenë emetime CO₂ më pak se 95 g/km ose të jenë hibride/elektrike.

Zbatim kriteri: Certifikata e Konformitetit (Certificate of Conformity – CoC) si dokument zyrtar nga prodhuesi që përmban të dhëna teknike të automjetit, përfshirë Emetimet e CO₂ të shprehura në g/km dhe teknologjinë e motorit: hibride, elektrike ose me djegie të brendshme. Dokumenti teknik që specifikon, Tipin e automjetit, Nivelin e emetimeve të CO₂, Teknologjinë e përdorur (p.sh. motor elektrik, hibrid, Euro 6, etj.); Leja e qarkullimit përmban të dhënat e emetimeve në CO₂ dhe llojin e motorit; Deklaratë e firmosur nga operatori që garanton se automjeti i ofruar ka emetime më të ulëta se 95g CO₂/km ose është hibrid/elektrik dhe e shoqëron me një nga dokumentet më sipër dhe dokumentuar në fazë e dytë të prokurimit / dorëzimi i dokumentacionit provues. Për automjetet elektrike ose hibride, prodhuesi mund të lëshojë një certifikatë që e identifikon qartë teknologjinë si Zero Emission ose Low Emission Vehicle.

» Certifikim për emetime sipas standardit Euro 6.

Zbatim kriteri: Dokument zyrtar i lëshuar nga prodhuesi ose autoritetet e licencuara që vërteton përputhjen e automjetit me standardin Euro 6 për emetimet. Ky dokument përmban të dhëna teknike për emetimet e gazrave (NO_x, CO, PM, etj.) dhe konfirmon që automjeti është i certifikuar sipas normës Euro 6. Leja e qarkullimit për automjetet përfshin specifikimin e standardit të emetimeve që automjeti përmbush (Euro 6 në rubrikën përkatëse). Dokument teknik i lëshuar nga prodhuesi i automjetit që përshkruan standardin e emetimeve për modelin konkret. Ky dokument mund të jetë pjesë e manualit teknik, katalogut zyrtar apo dokumenteve të ofertës. OSE Deklaratë e firmosur nga operatori që garanton se automjeti i ofruar është në përputhje me standardin Euro 6 dhe e shoqëron me një nga dokumentet më sipër dhe dokumentuar në fazën e dytë të prokurimit/dorëzimi i dokumentacionit provues.

» Teknologji që redukton konsumin e karburantit.

Zbatim kriteri: Fletë-specifikimi teknik nga prodhuesi, Dokument zyrtar që tregon se automjeti apo pajisja është e pajisur me teknologji që redukton konsumin e karburantit, si: Sistemi “Start-Stop”, Motora me efikasitet të lartë (p.sh. Euro 6, GDI, TDI Efficient, Hybrid), Teknologji të frenimit me rikuperim të energjisë, Optimizim aerodinamik ose kontroll elektronik i konsumit. Specifikimet duhet të përfshijnë edhe konsumin mesatar të karburantit në l/100 km. Prodhuesi ose distributori mund të lëshojë certifikatë që tregojnë se teknologjia e përdorur ka efekt të matshëm në reduktimin e konsumit. Këto certifikata shpesh bazohen në standarde ndërkombëtare (p.sh. WLTP – Worldwide Harmonized Light Vehicle Test Procedure). Raport i testimit nga laborator i akredituar që vërteton konsum të ulët krahasuar me standardet mesatare të tregut. Deklaratë e firmosur që përshkruan qartë teknologjinë që përdor automjeti/pajisja dhe efektin e saj në reduktimin e konsumit dhe e shoqëron me një nga dokumentet më sipër dhe dokumentuar në fazën e dytë të prokurimit/dorëzimi i dokumentacionit provues.

» Emisioni i zhurmës (ndotja akustike).

Zbatim kriteri: Automjetet e ofruara duhet të kenë nivel zhurme më të ulët se 72 dB(A), në përputhje me standardet e zhurmës për automjetet motorike (Direktiva 540/2014/EC ose

ekuivalente). Certifikata e konformitetit (CoC) përmban të dhëna për nivelin e zhurmës së automjetit gjatë funksionimit (testuar sipas metodave standarde BE-së). Fletë teknike e prodhuesit duhet të përfshijë zhurmën e matur në dB(A) në kushte standarde (testim statik dhe në lëvizje). Deklaratë konfirmimi që automjeti i ofruar ka nivel zhurme në përputhje me kufirin e kërkuar dhe është projektuar për të reduktuar ndotjen akustike.

» Vlerësimi i ciklit të jetës (Life Cycle Assessment).

Zbatim kriteri: Preferohen automjete për të cilat është kryer një vlerësim i ciklit të jetës që dokumenton ndikimin mjedisor nga prodhimi deri në fundin e jetës së automjetit dhe që demonstron performancë më të ulët mjedisore sesa modelet konvencionale ekuivalente. Raport i përgatitur nga prodhuesi ose palë e tretë që vlerëson ndikimin në mjedis të automjetit në terma të: Emetimeve CO₂ gjatë gjithë ciklit, konsumit të energjisë dhe ujit, shfrytëzimit të materialeve dhe mbetjeve, fundi i jetës dhe riciklimi. Çertifikatë ISO 14044: 2006, për vlerësimin e ciklit të jetës.

BLERJE MATERIALE KANCELARIE

Kriteret mjedisore:

» Letra të jetë 100% e ricikluar/riciklueshme ose me EU Ecolabel.

Zbatim kriteri: Çertifikatë EU Ecolabel për letrat që ofron, që tregon përputhshmërinë me standardet e qëndrueshmërisë dhe riciklimit. Dokument zyrtar nga prodhuesi/furnizuesi që tregon se letra është 100% e bërë nga materiale të ricikluara. Raport analizë që tregon përqindjen e materialit të ricikluar në letrat e ofruara.

» Produkte pa PVC, të biodegradueshme ose me ambalazh të riciklueshëm.

Zbatim kriteri: Çertifikate EU Ecolabel, Blue Angel, OK Compost, TÜV Austria, që konfirmojnë biodegradueshmërinë ose mungesën e PVC-së, ISO. Etiketim në përputhje me direktivat e BE-së për ambalazh dhe mbetje p.sh. simboli i riciklimit, kodi i identifikimit të materialit ose përshkrim i biodegradimit të ambalazhit.

» Produkte që nuk përmbajnë substanca të dëmshme.

Zbatim kriteri: Skedë teknike dhe/ose Çertifikatë cilësie e lëshuar nga prodhuesi.

» Produkte pa përmbajtje VOC (tretës organikë të paqëndrueshëm).

Zbatim kriteri: Produktet kancelarike që përmbajnë bojëra, ngjitës ose korrektorë (p.sh. markues, korrektorë likuidë, ngjitës me solvent), duhet të jenë pa përmbajtje VOC ose të kenë përmbajtje shumë të ulët të tyre ($\leq 1\%$). Dokument teknik (Skedë teknike ose Çertifikate cilësie) i produktit që liston përbërjen kimike dhe përqindjen e VOC-ve. Etiketim i produktit me shënime “VOC-free”, “Low VOC”, ose “solvent-free” mbi ambalazh.

BLERJE UNIFORMASH

» Uniforma të prodhuara nga materiale organike ose të ricikluara dhe me procese prodhimi me ndikim të reduktuar mjedisor.

Zbatim kriteri: Uniformat duhet të jenë të prodhuara nga materiale natyrale organike (p.sh., pambuk organik) ose nga fibra të ricikluara (p.sh., poliestër i ricikluar), dhe prodhuesi duhet të aplikojë procese me ndikim të reduktuar mjedisor, si përdorimi i teknologjive që kursejnë ujë dhe energji, dhe/ose certifikime të qëndrueshmërisë (p.sh., GOTS, OEKO-TEX Standard 100). Certifikata GOTS (Global Organic Textile Standard), OEKO-TEX Standard 100, ose certifikata të tjera të njohura për qëndrueshmërinë e tekstileve.

» Uniforma të prodhuara me materiale që kanë gjurmë karboni të ulët.

Zbatim kriteri: Uniformat duhet të jenë prodhuar nga materiale që kanë një gjurmë karboni të certifikuar të ulët gjatë gjithë ciklit të jetës (nga prodhimi i fibrave deri te përpunimi dhe transporti), duke kontribuar në reduktimin e emetimeve të gazrave serë. Certifikatë për gjurmën e karbonit (p.sh., PAS 2050, ISO 14067) nga prodhuesi. Fletë analizë që vërteton përmbajtjen e karbonit.

» Paketim i reduktuar, i biodegradueshëm ose i riciklueshëm për uniformat.

Zbatim kriteri: Uniformat duhet të jenë të paketuara në materiale që janë të biodegradueshme, të riciklueshme ose me paketim minimal, për të reduktuar ndikimin negativ mjedisor nga mbetjet plastike. Certifikatë për materialet e paketimit (p.sh., EU Ecolabel për paketim, ose deklaratë nga prodhuesi/furnizuesi).

» Përdorimi i bojërave me bazë ujore në prodhimin e uniformave.

Zbatim kriteri: Uniformat duhet të jenë ngjyrosur me bojëra që nuk kanë në përmbajtje komponime organike volatile por me bazë ujore. Certifikata OEKO-TEX ose deklaratë nga prodhuesi/furnizuesi për përdorimin e bojërave me bazë ujore.

BLERJE MATERIALE TE BUTA

» Materiale të buta me përmbajtje të paktën 30% materiale të ricikluara ose natyrale.

Zbatim kriteri: Disa certifikata të pranura gjerësisht përmbajnë informacion mbi përbërjen e materialit: Global Recycled Standard (GRS), Recycled Claim Standard (RCS), OEKO-TEX® (për tekstile të sigurta për shëndetin dhe që mund të përfshijnë materiale natyrale), GOTS (Global Organic Textile Standard) – për materiale natyrale organike.

» Mundësia e riciklimit në fund të ciklit të jetës.

Zbatim kriteri: Materialet e buta të ofruara duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë që të mund të riciklohen në fund të ciklit të përdorimit të tyre pa kërkuar ndarje të ndërlikuar të përbërësve ose trajtime të veçanta të dëmshme për mjedisin. Certifikatë mbi riciklueshmërinë nga një institucion

i njohur ose skemë vullnetare (p.sh. Cradle to Cradle Certified™, Recyclability Certification etj.). Deklaratë nga prodhuesi që konfirmon se produkti është i përshtatshëm për riciklim dhe nuk përmban trajtime që e pengojnë atë. Përshkrim të strukturës së materialit (lloji dhe përqindja e fibrave) dhe të çdo trajtimi të bërë mbi produktin.

BLERJE KARBURANTI

» Karburant ULSD (me përmbajtje të ulët squfuri).

Zbatim kriteri: Analizë laboratorike nga një laborator i akredituar, që tregon përmbajtjen e sqfurit ≤ 10 ppm.

» Raportim mbi emetimet e gazrave dhe gjurmët e karbonit nga operatori.

Zbatim kriteri: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një raport të përgatitur nga vetë ai ose nga një palë e tretë, që përfshin: Llogaritjen e emetimeve të gazeve serë (GHG) për të paktën një vit fiskal. Të përfshihen zakonisht emetimet e kategorive: Scope 1 – Emetime direkte (nga automjetet, ngrohja, etj.), Scope 2 – Emetime indirekte nga konsumi i energjisë elektrike, (opsional) Scope 3 – Emetime nga zinxhiri i furnizimit, transporti i mallrave, etj.

BLERJE ORENDISH DHE PAJISJE

» Mobilie me dru të certifikuar FSC/PEFC.

Zbatim kriteri: Paraqitja e Certifikatës origjinale FSC ose PEFC (nga kompani certifikuese të akredituara që mund të jenë kompani të huaja me shërbim ndërkombëtar).

» Lyerje dhe bojëra pa përmbajtje të lartë VOC.

Zbatim kriteri: Dokument teknik (Skedë teknike ose Certifikatë cilësie) i produktit që liston përbërjen kimike dhe përqindjen e VOC-ve. Etiketimi i produktit me shënime “VOC-free”, “Low VOC”, ose “solvent-free” mbi ambalazh.

BLERJE TONERASH

» Përdorimin e tonerave me përbërës me bazë të ricikluar ose material biokompatibil.

Zbatim kriteri: Dokument zyrtar nga prodhuesi që tregon përqindjen ose përbërjen e materialeve të ricikluara ose biokompatible në toner. MSDS-Informacion i detajuar mbi përbërjen kimike të tonerit, duke përfshirë përmbajtjen e materialeve të ricikluara ose biokompatible. Analiza laboratorike/Testime të pavarura që vërtetojnë përbërjen e tonerit në përputhje me kërkesat e riciklimit ose biokompatibilitetit. Etiketimi ekologjik ose certifikata të njohura si p.sh. EU Ecolabel.

» Toner të ricikluar/refill ose kompatibilë që përmbajnë sasi minimale të materialeve të dëmshme.

Zbatim kriteri: Dokument zyrtar/Katalog që deklaron se tonerët janë të ricikluar, refill ose kompatibilë dhe përmbajnë sasi minimale të substancave të dëmshme (p.sh. metale të rënda, PVC,

ftalate). MSDS/Informacion i detajuar mbi përbërjen kimike të tonerëve, duke përfshirë përmbajtjen e materialeve të ndaluara ose të kufizuara. Raporte/analiza nga laboratorë të akredituar që vërtetojnë përmbajtjen minimale të materialeve të dëmshme.

» Paketim me materiale të ricikluara dhe të riciklueshme.

Zbatim kriteri: MSDS/Informacion specifik mbi llojin dhe karakteristikat e materialeve të paketimit. Raport/analiza nga laboratorë të akredituar që vërtetojnë përmbajtjen minimale të materialeve të dëmshme. Simbole të riciklimit ose etiketat e certifikuar për materialet e riciklueshme (p.sh. simboli i riciklimit, FSC për kartonin, etj.).

BLERJE DETERGJENTESH DHE KIMIKATE

» Produkte që nuk përmbajnë përbërës të rrezikshëm për ambientin dhe shëndetin (si fosfate, EDTA, VOC, klor i lirë).

Zbatim kriteri: Skedë teknike (përbërësit e produktit) dhe MSDS/Informacion specifik mbi kushtet e ruajtjes dhe transportit të produkteve.

» Përputhshmëria me standardin REACH.

Zbatim kriteri: Deklaratë përputhshmërie me standardin REACH.

» Produktet të jenë biologjikisht të biodegradueshme.

Zbatim kriteri: Skeda e të dhënave teknike (SDS e produktit), etiketa e produktit.

» Paraqitja e një politike mjedisore dhe zbatimi i ISO 14001.

Zbatim kriteri: Metodologji që mund të përfshijë reduktim të ndikimit klimaterik, transport i gjelbër, emetim i CO₂ në nivele të ulta, etj..

Shembuj për Kriteria Mjedisore për disa nga prokurimet kryesore sipas kategorive, realizuar nga OBP/ për SHERBIME.

SHERBIM PASTRIMI

» Përdorimi i detergjentëve me përbërje të biodegradueshme.

Zbatim kriteri: Certifikata të njohura ndërkombëtare si: EU Ecolabel, OECD guidelines (si OECD 301), ISO 17088 / ISO 14021. Material Safety Data Sheet (MSDS) ose Safety Data Sheet (SDS) për çdo detergjent duhet të përmbajë informacion mbi Biodegradueshmërinë e përbërësve, Përputhshmërinë me udhëzimet OECD., Përqindjen e substancave që degradojnë në mënyrë natyrale. Analiza laboratorike për të matur degradimin biologjik të përbërësve aktivë.

» Produktet e përdorura të kenë certifikatë “Green Seal” ose ekuivalente, paraqitja e saj përmbush kriterin.

» Plani i riciklimit dhe ndarjes së mbetjeve gjatë ofrimit të shërbimit.

Zbatim kriteri: Ky është dokumenti kryesor dhe përmban:

Kategoritë e mbetjeve që gjenerohen gjatë shërbimit (organike, plastike, letër, metal, të rrezikshme, etj.).

Metodat e ndarjes dhe grumbullimit në burim.

Vendndodhja e pikave të grumbullimit dhe kontenerëve.

Frekuenca e dorëzimit për riciklim.

Pika fundore (operatori i mbetjeve ku dorëzohen).

Personat përgjegjës dhe trajnimi i stafit.

Objektivat mjedisore (p.sh., riciklim 80% të mbetjeve jo-organike).

Kontratë ose marrëveshje me kompani të licencuar për trajtimin e mbetjeve.

Dëshmon që mbetjet e riciklueshme nuk hidhen rastësisht, por trajtohen nga kompani të licencuara për riciklim.

Duhet të përmbajë: emrin e kompanisë, datën e marrëveshjes, llojet e mbetjeve që merren, mënyra e trajtimit (riciklim / përpunim).

» Reduktimi i Paketimit dhe Përdorimit të Plastikës në Shërbimin e Pastrimit.

Përshkrimi i kriterit: Ofruesi i shërbimit të pastrimit duhet të minimizojë përdorimin e paketimeve plastike njëpërdorimshe dhe të promovojë përdorimin e ambalazheve të ripërdorshme ose të riciklueshme si dhe të zbatojë praktika që reduktojnë ndotjen plastike gjatë furnizimit dhe ekzekutimit të shërbimit të pastrimit.

Zbatim kriteri: Deklaratë nga furnizuesi ose prodhuesi për përmbajtjen e riciklueshme të paketimit. Lista e produkteve të pastrimit të përdorur me informacion mbi: Llojin e ambalazhit, Materialin përbërës të paketimit.

SHERBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI

» Reduktimi i plastikës dhe përdorimi i paketimit të riciklueshëm.

Zbatim kriteri: Deklaratë nga furnizuesi ose prodhuesi për përmbajtjen e riciklueshme të paketimit. Lista e produkteve të pastrimit të përdorur me informacion mbi: Llojin e ambalazhit, Materialin përbërës të paketimit.

» Menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara nga shërbimi i gatimit dhe shpërndarja e ushqimit, ndarja në burim e tyre sipas natyrës: organike, plastike, metalike, letër etj.

Zbatim kriteri: Plan i detajuar për ndarjen në burim të konfeksioneve/paketimeve që do të përdoren në mënyrë që grumbullimi pas përdorimit të kryhet lehtësisht duke shmangur dhe mundësinë e përzierjes së materialeve me natyrë të ndryshme përbërësish.

» Kompostimi i mbetjeve organike.

Zbatim kriteri: Disponim teknologjie për trajtimin e integruar të mbetjeve duke i shndërruar në pleh natyral.

» Eliminimi i paketimeve njëpërdorimëshe (gota, thika, pjata, pirunj etj.). Zëvendësimi i tyre me enë me materiale të biodegradueshme ose përdorimi i enëve të ripërdorshme (qelq, çelik, inoks, porcelan etj.).

Zbatim kriteri: Fatura blerje të produkteve pa përmbajtje plastike.

» Përdorimi i tericave ushqimore duke i shpërndarë në institucione/organizata bamirëse për njerëzit në nevojë.

Zbatim kriteri: Kontrata donacioni për organizata/shoqata me karakter përkujdesi social.

SHERBIM LAVANDERIE

» Përdorimi i detergjentëve biodegradues dhe të certifikuar.

Zbatim kriteri: Përdorimi i detergjentëve dhe kimikateve të pastrimit që janë të biodegradueshme dhe me certifikata mjedisore (si p.sh. “Green Seal”, “EcoLabel”).

» Reduktimi i konsumit të ujit.

» Përdorimi i pajisjeve moderne me teknologji që kursen ujë (p.sh. makineri me cikle të shkurtuara dhe funksion vetë rregullimi).

Zbatim kriteri: Raportet e matjes së konsumit të ujit- Regjistrime periodike (ditore, mujore) të konsumit të ujit për lavanderinë, që tregojnë reduktim të sasisë së përdorur krahasuar me periudhat e mëparshme. Certifikata ose manualë teknikë që tregojnë se makineritë e lavanderisë janë me efikasitet në përdorimin e ujit (p.sh. pajisje me certifikata për kursim uji). Raportet e mirëmbajtjes dhe inspektimeve- Dokumente që vërtetojnë se pajisjet janë mirëmbajtur dhe funksionojnë në mënyrë optimale për kursimin e ujit (p.sh. kontroll i rrjedhjeve, shfrytëzimi i cikleve me ujë të reduktuar). Politikat dhe procedurat operative- Dokumente të brendshme ku përshkruhen praktikatat e zbatimit të cikleve me konsum të ulët uji, trajnimi i stafit për përdorim efikas, dhe masat e tjera për reduktimin e ujit. Auditimet e brendshme ose të palëve të treta-Raporte auditimesh që vlerësojnë dhe konfirmojnë reduktimin e konsumit të ujit në shërbimin e lavanderisë. Pajisje të avancuara që ripërdorin ujin larës në më shumë se një herë duke mundësuar reduktim të ujit të përdorur dhe shkarkimeve në rrjetin e kanalizimeve.

» Kursimi i energjisë.

Zbatim kriteri: Raportet e matjes së konsumit të energjisë. Regjistrime të sakta periodike (ditore, mujore) të konsumit të energjisë elektrike në lavanderi, që tregojnë ulje ose konsum efikas krahasuar me periudhat e mëparshme. Certifikatat e pajisjeve me efikasitet energjetik/Dokumentacion që dëshmon se makineritë dhe pajisjet e përdorura janë me klasë të lartë energjetike (p.sh. Energy Star, EU Energy Label). Raportet e mirëmbajtjes dhe inspektimeve/Dokumente që tregojnë mirëmbajtjen periodike të pajisjeve për të siguruar funksionimin optimal dhe efikasitetin energjetik. Politikat dhe procedurat operative/Dokumente të brendshme që përshkruajnë praktikën për përdorimin e cikleve me konsum të ulët energjie, fikjen e pajisjeve kur nuk përdoren dhe trajnimin e stafit për kursim energjie. Auditimet e brendshme ose të palëve të treta/ Raporte të auditimeve që vlerësojnë dhe konfirmojnë masat e kursimit të energjisë në lavanderi.

» Përdorimi i detergjentëve ekologjikë, pa përmbajtje fosfate, pa përbërës toksikë ose të dëmshëm për ujin dhe shëndetin.

» Menaxhimi i ujërave të ndotura përmes sistemeve për trajtimin e tyre përpara shkarkimit në rrjetin e kanalizimeve.

» Menaxhimi i mbetjeve dhe kimikateve.

Zbatim kriteri: Regjistrimi i mbetjeve të prodhuara/ Dokumentacion zyrtar (lista, regjistra) ku evidentohen sasia dhe llojet e mbetjeve të kimikateve dhe produkteve të përdorura në lavanderi. Procedurat dhe politikat e menaxhimit të mbetjeve/Dokumente të shkruara që përshkruajnë mënyrën e grumbullimit, ruajtjes, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve kimike sipas standardeve mjedisore dhe ligjore. Kontratat me operatorë të autorizuar për menaxhimin e mbetjeve/ Kopje të kontratave dhe dokumentacionit me kompanitë ose operatorët që merren me mbledhjen, riciklimin ose asgjësimin e sigurt të mbetjeve. Certifikatat e trajtimit të mbetjeve/ Dëshmi nga operatorët që tregojnë se mbetjet janë trajtuar ose asgjësuar në mënyrë të sigurt dhe të ligjshme. Auditimet dhe inspektimet mjedisore/ Raporte nga inspektimet ose auditimet e brendshme ose të palëve të treta që konfirmojnë respektimin e standardeve për menaxhimin e mbetjeve dhe kimikateve. Trajnimi i stafit/ Regjistrat e trajnimeve të stafit mbi menaxhimin e sigurt të kimikateve dhe mbetjeve.

SHERBIM TRANSPORTI/LOGJISTIKE

» Mjete me emetim zero ose Euro 6.

Zbatim kriteri: Dokument zyrtar i lëshuar nga prodhuesi ose autoritetet e licencuara që vërteton përputhjen e automjetit me standardin Euro 6 për emetimet. Ky dokument përmban të dhëna teknike për emetimet e gazrave (NOx, CO, PM, etj.) dhe konfirmon që automjeti është i certifikuar sipas normës Euro 6. Leja e qarkullimit për automjetet përfshin specifikimin e standardit të emetimeve që automjeti përmbush (Euro 6 në rubrikën përkatëse). Dokument teknik i lëshuar nga

prodhuesi i automjetit që përshkruan standardin e emetimeve për modelin konkret. Ky dokument mund të jetë pjesë e manualit teknik, katalogut zyrtar apo dokumenteve të ofertës ose deklaratë e firmosur nga operatori që garanton se automjeti i ofruar është në përputhje me standardin Euro 6 dhe e shoqëron me një nga dokumentet më sipër dhe dokumentuar në fazën e dytë të prokurimit/dorezimit të dokumentacionit provues.

» Menaxhim i konsumit të karburantit (GPS + telemetri).

Zbatim kriteri: Kontrata ose fatura e instalimit të pajisjeve GPS/telemetri/ Dokument që tregon se kompania ka blerë ose ka nënshkruar një kontratë për shërbime GPS dhe telemetrie/mund të përfshijë pajisjet si: sensorë të karburantit, kompjuter bordi, moduli i transmetimit të të dhënave, etj. Certifikatë ose dokumentacion teknik i sistemit/ Manuali teknik i sistemit të telemetrisë/ Përshkrim funksional që tregon se sistemi monitoron karburantin dhe të dhënat e drejtimit. Pamje nga platforma softwerike (screenshot/evidencë digjitale)/ Foto nga softweri që tregon: (Konsumin e karburantit në kohë reale, Rugët e përshkuara, Eventet e drejtimit (p.sh. frenime të forta, qëndrime me motor ndezur), Raporte ditore/mujore). Raporte analitike të prodhuara nga sistemi/ Raporte që tregojnë: Konsumin për çdo automjet, Devijime në përdorim, Analizë e sjelljes së shoferëve, Anomali në karburant (p.sh. vjedhje ose harxhime të pashpjeguara). Politika e brendshme e përdorimit të sistemit/ Dokument i brendshëm ku përcaktohet se si përdoret ky sistem për të monitoruar dhe menaxhuar flotën dhe karburantin. Deklaratë zyrtare që konfirmon funksionalitetin dhe përdorimin aktiv të sistemit.

SHERBIM DEZINFEKTIM, DEZINSEKTIM, DERATIZIM (DDD)

» Përdorimi i agjentëve biologjikë.

Zbatim kriteri: Skedë teknike ose MSDS e produktit.

» Përputhshmëria me standardin REACH.

Zbatim kriteri: Deklaratë përputhshmërie me standardin REACH.

» Plan për menaxhimin e mbetjeve pas dezinfektimit dhe dezinfektimit.

Zbatim kriteri: Dokument dëshmuës, plan ose metodologji për menaxhimin e këtij procesi.

» Staf i trajnuar për përdorim të produkteve biocide.

Zbatim kriteri: Çertifikata profesionale nga organe të licensuara.

SHERBIM LYERJE DHE MIREMBAJTJE NE NDERTESA PUBLIKE

» Materialet e përdorura për lyerje (bojra, llakë, primer, tretës) duhet të jenë me bazë uji, pa përmbajtje të lartë të përbërësve organikë të paqëndrueshëm ($VOC \leq 30g/L$).

Zbatim kriteri: Çertifikim mjedisor të vlefshëm (p.sh. EU Ecolabel, Nordic Swan, Blue Angel ose ekuivalente). Lista e produkteve të planifikuara për përdorim dhe fletë të dhënash teknike që tregojnë përmbajtjen VOC.

» Riciklim i ambalazhit dhe planifikim për menaxhimin e mbetjeve.

Zbatim kriteri: Planin për menaxhimin e mbetjeve i cili përfshin ndarjen, mbledhjen dhe riciklimin e të gjithë ambalazheve të përdorura gjatë ofrimit të shërbimit. Të gjitha mbetjet duhet të dërgohen tek operatorë të certifikuar për riciklim dhe të paraqitet raport periodik mbi masat e zbatuara.

Reduktimi i ndotësve të ajrit: Përdorimi i pajisjeve moderne që reduktojnë shpërndarjen e kimikateve në ajër. Përdorimi i produkteve pastruese ekologjike dhe të biodegradueshme.